

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Nexhmi Hyseni nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.24896/11, datë 27.07.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 31.10.2012 merr

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i atakuar dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr.regj.24896/11, të datës 27.07.2012, të pandehurin Nexhmi Hyseni nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjëse sepse si zyrtar i lartë publik, Drejtor i Klinikës Kirurgjisë së fëmijëve nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjor 31 mars 2011, në Agjencionin Kundër Korrupsion, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhje dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe deklarimin e Kontrollin, Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5,6 e neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par. 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen edhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 2000.-€ (Dymijë euro), duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5.-€ (pesë euro).

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë për shkak të:

- shkeljes së dispozitave të ligjit mbi kundërvajtjet,
- vërtetimit jo të plot dhe të gabuar të gjendjes faktike,
- aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe
- vendimit mbi dënimin.

Në arsyetim të ankesës përpos tjerash thekson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave ligjore pasi që e ka pazhvilluar procedurën fare pa e thirrur ushtruesin e kërkesës për tu deklaruar rreth kundërvajtjes që i veket në barrë të pandehurit, se Agjencia nuk ia ka dërguar të pandehurit formularin për deklarim të pasurisë me çka kjo si ushtrues kërkesë nuk e ka kryer obligimin e vet. Më tutje thekson se ky në pozitën e Drejtorisë së Klinikës së Kirurgjisë, sipas ligjit nuk mund të konsiderohet Zyrtarë i lartë publik dhe as Agjencia nuk e ka dokumentuar bindshëm këtë fakt, se dënimi i shqiptuar është i pakuptimtë dhe i pajustificueshëm etj. andaj propozon që aktvendimi i atakuar të ndryshohet ashtu që ndaj të pandehurit të pezullohet procedura kundërvajtëse ose i njëjti aktvendim të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarimin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 25.07.2012 me ç'rast mohon të jetë njoftuar për obligimin e deklarimit të pasurisë për vitin 2012 ashtu siç parashihet me ligj, si dhe nga dëshmia e dëshmitarit Haki Smajli-zyrtar i lartë i personelit Ministria e Shëndetësisë

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOŠOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIA PROTIV KORUPCIE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. DPK/DMP	03-4313/12
Dep.	Prat No.
Kodi i	Data
Identifikimit	30.11.2012
02	
PRISHTINE	

2.

në Prishtinë të dhënë më datë 22.10.2012 i cili thekson se personalisht ia ka dorëzuar formularin për deklaram të pasurisë tani të pandehurit për vitin 2012, përkundër faktit se i pandehuri ngarkohet për kundërvajtjen e kryer për vitin 2011, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ankesën e paraqitur e aprovoi si të bazuar, kurse aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të:
-shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse dhe
-vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe
-të shkeljeve ligjore.

Shkeljet procedurale kanë të bëjnë me faktin se kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse e ngarkon të pandehurin për dy kundërvajtje dhe atë për mos deklaram të rregullt vjetor të pasurisë nga neni 6 dhe për mos deklaram të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës nga neni 7 të Ligjit nr.03/L-151, kurse gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në tërësi sipas kërkesës por të pandehurin e ka shpall fajtor vetëm për mos deklaram të rregullt vjetor të pasurisë dhe i ka shqiptuar gjobën prej 2000.-€ në vështrim të nenit 5,6 e 8 dhe dispozita sanksionuese nen 17 1.1 të Ligjit nr. 04/L-050 me çka ka bërë njëherit edhe shkelje ligjore duke marr parasysh se ky ligj (04/L-050) ka hyrë në fuqi më 15.09.2011 derisa në kohën e kryerjes së kundërvajtjes ka qenë në fuqi Ligji nr.03/L-151 sikurse që ngarkohet në kërkesë për fillim të procedurës kundërvajtëse dhe i cili Ligj është më i favorshëm për të pandehurin.

Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me faktin se i pandehuri e ka mohuar të jetë njoftuar në mënyrë të rregullt ligjore për obligimin e tij për deklaram të pasurisë për vitin 2011, kurse nga deklarama e dëshmitarit të dhënë në gjykatë nuk vërtetohet se kur dhe si e ka njoftuar të pandehurin për obligimin e deklaramit të pasurisë për vitin 2011.

Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë duhet të veproj sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, duke iu përmbajtur kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse kurse për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike të merr në pyetje ushtruesin e kërkesës ose Zyrtarin kontaktues i cili do të dëshmoj bindshëm që e ka njoftuar të pandehurin ashtu siç parashifet me ligj për obligimin e deklaramit të pasurisë, të administroj edhe ndonjë provë tjetër eventuale dhe më në fund të merret aktvendim i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga sa u tha më lartë, konform nenit 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,
GJL.nr.1200/12 të datës 31.10.2012.

SEK. JURIDIKE,
Zymrije Cunaku



KRYETARI I KOLEGJIT,
Dalip Bega